

# SHKOLLA FILLORE KOMUNALE „BRATSTVO-MIGJENI,, TETOVË

## BROSHURË



2023-2024

## LETRA E NJOHTIMIT TË SHKOLLËS

Sh.FK. "Bratstvo-Migjeni" nga Tetova është një ndër shkollat më të vjetra dhe është themeluar qysh më vitin 1958 nën emrin „Bratstvo-Edinstvo„. Ka qenë dhe është e vendosur në rrugën L.B.Pish nr. 41. Shkolla gjithashtu ka edhe 3 objekte shkollore edhe atë një në qendrën sportive dhe një në Saraqinë( shkolla periferike) dhe në lagjen Drenovec. Në shkollë mësojnë nxënës nga lagjet „B.Kidriq,, „Q.Sportive,, „Drenovec,, dhe Saraqinë.

Në këtë shkollë në vitin 1958 mësimi është zhvilluar në gjuhën maqedone dhe shqipe prej kl.I – VIII. Më vonë fillon edhe mësimi në gjuhën turke prej kl I – IV. Prej atë here deri sot shkolla është zhvilluar dhe zhvillohet si shkollë qendrore me shkollë periferike në vendbanimin Saraqinë dhe 2 objekte dislocuara (qendër dhe Drenovec) . Në vitin 1993 shkolla e ndërton emrin në „Bratstvo-Migjeni„. Sot shkollën e ndjekin nxënësit me mësim në gjuhën maqedone prej kl I - IX në Tetovë dhe Saraqinë , me mësim në gjuhën shqipe prej kl I- IX në Tetovë dhe prej Kl I – V në Saraqinë , ndërsa me mësim në gjuhën turke prej I – V.

## KUSHTET PËR PUNË TË SHKOLLË



Puna edukativo-arsimore zhvillohet në 4 objekte : në objektin qendror,qendrën sportive në lagjen Drenovec dhe Saraqinë.

Shkolla qendrore posedon klasa prej të cilave disa janë të vogla dhe të adaptuara ,në të cilat është e vështirë të realizohet mësimi bashkëkohor. Në shkollën qendrore realizohet mësimi me nx. me MGJSH prej klasës I e deri në klasë të IX dhe mësimi prej klasës së I deri në kl e V në MGJT(1 paral. të kombinuara)

Në objektin e ri në qendrën sportive ka 12 klasë ,hapsirë për mësim ditor dhe 2 hapsira bodrume por të adaptuara.Këtu nxënës. ndiqet mësimi prej klasës së I deri në klasën e IX në MGJM

Në shkollën periferike në Saraqinë ka klasa ku mësimi zhvillohet në gj.Shqipe prej kl.I-V. dhe gj.Maqedone prej kl.I-IX dhe në

Në lagjen Drenovec ka objekt për nxënësit nga klasa I deri te IX me mësim në gj. Shqipe në klasa të mëdha dhe bukur të reguluara

## MISIONI I SHKOLLËS

### Misioni

Implementimi i vlerave me të cilat arrihet një shkollë efektive në një mjedis multietik.

### Vizioni

Shkolla jonë do të jetë një mjedis që ofron mbështetje zhvillimit individual të të gjithë nxënësve dhe zhvillimit profesional të arsimtarëve, gjë që çon deri në një proces cilësor edukativo-arsimor.

### Eksperiencat e mësuara / fituara

Në planifikimin e aktiviteteve janë përdorur eksperiencat nga puna e shkollës në vitet e kaluara shkollore dhe analizat e punës së të gjitha organeve dhe trupave që funksionojnë në shkollën, si dhe realizimi i punës edukativo-arsimor në shkollën:

- Analizat dhe konkluzionet nga Inspektimi Integral
- Analizat dhe konkluzionet nga Vetëvlerësimi i fundit për punën në shkollë
- Plani për zhvillimin e shkollës
- Përvoja nga implemetimi i Konceptit të Ri për arsimin fillor
- Analizat dhe konkluzionet nga puna e Këshillit të arsimtarëve, Këshillit të klasave, Aktivitet profesional, Ekipit i inkluzionit dhe realizimit të Programit për zhvillimin profesional të kuadrit arsimor;
- Njohuritë e fituara nga trajnimet, eksperiencat nga realizimi i plan-programeve mësimore;
- Njohuri dhe aftësi të reja nga planifikimi, përgatitja dhe realizimi i mësimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore në shkollën tonë;
- Përfitimet e zbatimit të TIK-ut në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëshkollore;
- Pjesëmarrja në shumë gara, bashkëpunimi me prindërit, mjedisit lokal, mediat dhe organizata të tjera;

Anët e mira të shkollës janë:

- Implemetimi i Konceptit të Ri për arsimin fillor
- Sjellja shembullore e nxënësve
- Pjesëmarrja në projekte
- Respektimi i të drejtave të fëmijëve
- Inkluzioni i suksesshëm
- Orë me zbatimin e qasjeve të reja në punë si shembuj të praktikave të mira
- Pjesëmarrja në garat e nxënësve
- Aplikimi i multikulturalizmit me tendencë për pinterkultuarizëm

## PRIORITETET DHE QËLLIMET

Nga qëllimet strategjike të shkollës, prioritetet, mundësitë, burimet njerëzore dhe materiale, vetëvlerësimi i shkollës sonë, raportet e shkollës, nevojat e nxënësve, mësuesve dhe të punësuarit të tjerë, bashkëpunimi me prindërit dhemjedisin lokal, duke marrë parasysh misionin e përcaktuar dhe vizionin e vendosur, i përcaktuam nevojat për ndryshime në shkollën. U përpoqëm që t'i përcaktojmë kërkesat prioritare duke patur parasysh që ato duhet të jenë të arritshme dhe të jenë në kuadër të mundësive tona.

**PRIORITET: 1.** Ofrimi i mbështetjes për nxënësit që kanë nevojë për ndihmë për përparim më të suksesshëm në punën edukativo-arsimorë dhe nxënësit me nevoja të veçanta

**PRIORITET: 2.** Ndërtimi i dy klasave dhe sallave sportive në SHFK.

**PRIORITET: 3.** Bashkëpunimi më i madh i shkollës me prindërit/tutorët

**PRIORITET: 4.** Bashkëpunimi ndërmjet nxënësve, arsimtarëve dhe personave të tjerë kompetentë për zgjidhjen e problemeve që i shqetësojnë nxënësit – pjesëmarrja në “Ditën e Hapur nga Arsimi Qytetar”. “ – aplikimi i arsimit multietnik në veprim.

**PRIORITET: 5.** Implementimi i suksesshëm i Konceptit të ri për arsimin fillor nga klasa e parë deri në të gjashtë.

## TË PUNËSUAR

Në mësimin në gj.shqipe janë të kyqur 78 arsimtarë

Në mësimin në gj.maqedone janë të kyqur 56 arsimtarë

Në mësimin në gj. Turke , në grupin klasor janë të kyqur 7 arsimtarë

Në shkollë ka një drejtor , dy ndihmës drejtorë, një pedagog, një psikolog, një defektolog, 2 bibliotekar,1 punonjësit social, një sekretar, 1 kontabilist dhe 17 të punësuar si personel teknik.

Numri I nxënësve në vitin skollor 2023/24

	mësim në gj. shqipe	mësim në gj.maqedone	mësim në gj.turke
numri i paraleleve	33	50	4
numri i nxënësve	625	1044	21

## ORGANET E DREJTUESE, UDHËHEQËSE DHE PROFESIONALE TË SHKOLLËS

Bordi i shkollës
Drejtori
Ndihm. Drejtori / 2
shërbimi profesional ( pedagog, psikolog, defektolog, punonjësit social, 2 bibliotekiste)
Këshilli i prindërve
Aktivitetet profesionale
Kujdestarët e klasave
Anëtarët e ekipit inkluziv
Bashkësia e klasës
Anëtarët e parlamentit të nxënësve
Fëmiu ombudsman

### MËSIMI

( mësim në gj.shqipe, mësim në gj.maqedone dhe mësim në gj.turke)

#### Lloji i mesimdheneies

- Mesim obligativ
- Mesim zgjedhor
- Mesim plotësues
- Mesim shtues
- Programe individuale
- Programe për Eko aktivitete
- Projekte të cilat realizohen në shkollë
- Përdorimi i TIK-ut në mesim

Realizimi i programit të mesimdhënieve në të gjitha klasat do të ndiqet nga drejtori, ndihmes drejtori, shërbimi pedagogjik-psikologjik i shkollës, BZHA si dhe inspektoriati shtetëror i arsimit. Për këtë qëllim do të përgaditen instrumente për ndjekje të fushave të ndryshme të cilat do të jenë lende analitike në vetë orën. Do të ndermiren aktivitetet vijuese:

- Bashkepunim me drejtorin, shërbimin pedagogjiko-psikologjik si dhe me aktivet profesionale të mesimdhënësve nga kl. I-IX.
- Vizita neper ore nga ana e drejtorit, ndihmes dr dhe shërbim profesional me qelli qe te ndiqet realizimi I programit nga kl. I-IX.
- Bisede me nxenesit dhe prinderit per veshtiresite ne mesim
- Bisede dhe bashkepunim me mesimdhënesit-realizues.
- Trajnim profesional I mesimdhënësve permes vizitave ne trajnime .
- Ndjekje e rregullt e përvetesimit të materialit mesimor nga ana e individëve kompetent.
- Kontrollim I vazhdueshëm I dijes se nxenesve me përdorimin e vleresimit formativ dhe sumativ si dhe vleresimit ekstern.
- Kontrollimi i punës së mësimdhënësve të cilët nuk janë vlerësuar nga jashtë përmes vlerësimit të brendshëm.
- Analize e rezultateve të arritura dhe ndermarrja e aktiviteteve për të arritur rezultate edhe më të larta.

Mesimdhënësit punën edukativo-arsimore do ta realizojnë të fokusuar në risitë e punës me përdorim të formave dhe metodave bashkëkohore, demokratike të punës si dhe respektimin e dallimeve individuale mes nxënësve. Me qëllim për efikasitet më të madh në procesin arsimor si dhe rritje të kualitetit të dijenisë dhe përparimit të nxënësve, do të thellohet edhe bashkëpunimi mes nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve. Prandaj mësimdhënësit do të bashkëpunojnë me shërbimin pedagogjiko-psikologjik në shkollë, drejtorin dhe këshilltarët përkatës të BZHA me qëllim të vetëm për të arritur rezultate më të larta tek nxënësit.

#### Mësimi plotësues

Sipas fondit të nevojshëm për këtë lloj të orarit të paralelë llogaritet fondivjetor për çdo lëndë dhe për çdo arsimtar, i cili prej 20.09. bëhet pjesë e orarit dhe programit vjetor. Për mësim plotësues formimi i grupeve do të bëhet në kohë të ndryshme varësisht prej kohës kur do të paraqiten dobësi të caktuara të nxënësve të ndryshëm. Ky mësim do të organizohet përgjatë gjithë vitit mësimor, paralelisht me mësimin e rregullt, pas orëve mesimore, në kohën e lirë dhe si mësim vazhdueshëm në fund të vitit shkollor.

#### Mësimi shtues

Sipas fondit të nevojshëm për këtë lloj të orarit të paralelë llogaritet fondivjetor për çdo lëndë dhe për çdo arsimtar, i cili prej 20.09. bëhet pjesë e orarit dhe programit vjetor. Mësimi shtues do të realizohet me nxënës të cilët arrijnë rezultate të vecanta në Disiplinën të caktuar shkencore dhe përparojnë në kornizat e mësimin obligativ. Qëllimi i tij kryesor është që të sigurojë një punë sistematike me nxënës që kanë dhunti dhe talent gjatë gjithë vitit, angazhimin e tyre kreativ, përmirësimin e aftësive, orijentimin e ngushtë profesional, pjesëmarrja në gara etj.

#### AKTIVITETET EDUKATIVO-ARSIMORE JASHTAMËSIMORE

- Aktivitetet e lira të nxënësve (mësimi klasor dhe lëndor)
- Garat mes nxënësve
- Bashkësia e nxënësve
- Puna prodhuese dhe punët tjera të dobishme shoqërore
- Ekskursionet dhe shetitje të nxënësve ...etj.